



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 15.05.2017, merr këtë

V E N D I M

PËR BARTJEN E BUXHETIT TË PASHPENZUAR NGA VITI 2016 NË VITIN 2017

I.

MIRATOHET Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2016 në vitin 2017.

II.

Shuma e mjeteve të bartura, si në pikën I të këtij vendimi, është 8,746,590.03 €.

III.

Shuma e cekur në pikën II të këtij vendimi, destinohet si në vijim:

1. *Subvencione dhe transfere*, shuma prej 100,000.00 €;
2. *Investimet kapitale*, shuma prej 8,646,590.03 €.

IV.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe pjesa tabelore.

V.

Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjnë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-401/01-0112442/17, më 15.05.2017



KRYESUESI/KUVENDIT TË KOMUNËS
Halim Halimi, jur. i dipl.

Arsyetim

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi dhe Ligjin mbi buxhetin, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Nga viti 2016 në vitin 2017, barten mjetet në shumë prej 8,746,590.03€.

Ndryshimet dhe bartja e mjeteve sipas fushave nga viti 2016 në vitin 2017, është orientuar në këto kategori ekonomike:

- **Subvencione dhe transfere** - mjete në shumë prej 100,000.00 € të mbetura nga viti 2016.
- **Investime kapitale** - mjete në shumë prej 8,646,590.03 € të mbetura nga viti 2016. Nga kjo vlerë shumica janë projekte të kontraktuara në vitin 2016 dhe më herët, të cilat barten në vitin 2017. Disa projekte nga buxheti i vitit 2016 nuk janë realizuar, prandaj mjetet e planifikuara për këto projekte do të shpërndahen në projekte të tjera ekzistuese dhe në disa projekte të reja. Detajet për këto projekte janë të paraqitura në tabelat përcjellëse.